Promovimi i Ruajtjes së Natyrës dhe Roli i OJF-ve Mjedisore
Programi ACHIEVE (Shoqëri civile shqiptare
Për një Mjedis Evropian në Shqipëri)

Nihat DRAGOTI

Programi Achieve, i financuar nga BE (Delegacioni në Shqipëri), ka synim të përmirësojë bashkëpunimin mes Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC) dhe autoriteteve shtetërore, pjesëmarrjen aktive dhe cilësore në proceset legjislative, si dhe të mbajë një rol në e zbatimit të legjislacionit duke pasur parasysh si nismat publike ashtu dhe ato private. Përmes këtyre veprimeve do të ndihmohen OShC-t mjedisore edhe për të përmirësuar më tej strukturën e brendshme organizative, të rrisin cilësinë e stafit të tyre, të përfshijnë vullnetarët dhe të rrisin besueshmërinë dhe profilin e tyre në lidhje me komunitetet vendore ku ushtrojnë veprimtarinë.

Grupet kryesore të synuar të programit janë OShC-të mjedisore, duke përfshirë dhe organizatat me bazë komunitare dhe të rinjtë e vullnetarët. Përveç tyre do të përfshihen dhe Ministria e Mjedisit me agjencitë e saja, ministritë e linjës dhe Komisionet Parlamentare që kanë lidhje me mjedisin.

Objektivi i përgjithshëm i programit është:
Inkurajimi i shoqërisë civile për pjesëmarrjen aktive në hartim politikash dhe në kontributin për plotësimin e detyrimeve të Shqipërisë nën Marrëveshjen e Stabilizim Asocijimit Shqipëri-BE.

Ndërsa objektivi specifik është:
Grup i qëndrueshëm OShC i aftë që të punojë në mënyrë profesionale dhe të qëndrueshme, duke adresuar në bashkëpunim me OShC-t e tjera dhe aktorë shtetërorë respektiv-çështjet mjedisore deri në nivel politikash.
Njëherazi programi do të adrersojë edhe nevojat e mëposhtme:

- Përmirësimin e bashkëpunimit të OShC me aktorët shtetërorë (autoritetet qëndrore dhe vendore).
- Mungesën e ekspertizës së OShC-ve në tematikat mjedisore.
- Mospërfshirjen e OShC-ve të vogla dhe çështjeve rajonale në programet kombëtare.
- Qëndrueshmërinë e OShC-ve dhe lidhjen e tyre me komunitetet vendore.

Fushat e programit për OShC-t do tëjenë:
(i) Cilësia e Ajrit; (ii) Mbrojtja e Natyrës; (iii) Menaxhimi i Mbetjeve dhe (iv) Legjislacioni Horizontal.

Adr.:Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania
Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org
INCA ALBANIA

Ky program zbatohet nga REC-Albania, një organizatë me mision mbështetjen në adresimin e problemeve mjedisore. REC e përmbush misionin e saj duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet qeverive, organizatave joqeveritare, bizneseve dhe aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore. REC merr pjesë aktive në proceset globale, rajonale dhe lokale dhe ndihmon në zgjidhje të qëndrueshme e mjedisore brenda dhe përtej rrjetit të tij të zyrave, përmes kalimit të njohurive dhe përvojave në vende dhe rajone të ndryshme.

INCA bazuar në thirjen e hapur nga REC, ka aplikuar për një projekt në lidhje me promovimin e ruajtjes së mjedisit dhe të biodiversitetit në Shqipëri, duke patur në konsiderate gjendjen aktuale të tyre dhe domosdoshmërinë për t'u integruar, përshtatur dhe zbatuar standartet evropiane të ruajtjes së natyrës.

Siç dihet, shumica e burimeve natyrore në Shqipëri janë duke vuajtur nga presionet, janë nën kërcënime të vazhdueshme, duke përfshirë turizmin, prerjet e paligjshme, gjuetinë e pakontrolluar dhe aktivitete rekreative jo mirë të menaxhuara, erozioni dhe degradimi i tokës, zjarret, keqmenaxhimi i përdorimit i ujërave, ndërtimi i HEC-ve, etj.

Zbatimi i dobët i ligjit dhe një menaxhim joefektiv në praktikë mbetet ndër shqetësimet më kryesore të ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë janë lënë në haresë ligjet: "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit", "Për Gjuetinë", "Për Mbrojtjen e Faunës së Egër", "Për Mbrojtjen e Fondit të Bimëve Mjekësore, Eterovajore dhe Tanifere Natyrore" dhe "Për Përcaktimin e Rregullave dhe të Procedurave për Tregtimin Ndërkombëtar të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe të Florës së Egër".

Strukturat qendrore dhe lokale, që merren me ruajtjen dhe përdorimin e elementëve të biodiversitetit, si shërbimi pyjor, menaxherët e zonave të mbrojtura, Inspektoriati SHMP apo Peshkimit si dhe aktorët të tjerë, shpesh nuk kanë njohuri, aftësi dhe mjetet e mjaftueshme për zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi apo dhe më keq të Konventave Ndërkombëtare dhe të Direktivave të BE-s për Fushën e Ruajtjes së Natyrës.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në Shqipëri nuk është i integruar ende si duhet në politikën kombëtare dhe lokale. Ndër të tjera kjo ndodh pasi edhe përfshirja e komuniteteve lokale në vendimmarrjet për ruajtjen e natyrës, menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore nuk ka qënë i sukseshëm, ka ende një rrugë të gjatë për të kuptuar domosdoshmërinë për pjesëmarrjen e tyre në këtë proces.

Aktualisht, gjendja e rënduar mjedisore e vendit, tregon moszbatimin efektiv të politikave të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit, për zbatimin e dobët të ligjishmërisë, të mos vendosjes së kontrollit mbi territorin që lehtësisht të çojnë në konflikte të panevojshme dhe keqkuptime. Më e ndjeshme, kjo gjendje, është për komunitetet lokale që jetojnë në rajonet me biodiversitetit të larta të vendit, të cilët kanë nevojë për sigurimin e të ardhurave dhe

Adr.:Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania
Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org
INCA ALBANIA

përmirësimin e cilësisë së jetesës, nëpërmjet përdorimit të integruar dhe shumë funksional të burimeve natyrore, pa cënuar mbijetesën e elementeve të biodiversitetit.

Cilësia e jetës dhe e të ardhmes sonë varet nga mundësia jonë për të ruajtur mjedisin, ajrin, ujin, pyjet dhe gjallesat. Kjo është një sfidë për ne. Mbrojtja dhe promovimi i natyrës, dëmtimi dhe tjetërsimi i saj, keqtrajtimi i habitateve dhe specieve, humbjae biodiversitetit dhe e shërbimeve të ekosistemit apo dhe ndryshimete klimës, nuk janë rreziqe të panjohura, pasi ata janë të pranishëm në jetën tonë më shumë e kurrë. Ajo që është në rrezik është mbijetesa jonë, si dhe shumë gjallesave të tjera. Një natyrë e sigurt përmirëson cilësinë e jetës, shëndetin, prodhueshmërinë dhe rritjen e ekonomisë sonë. Ofron një mundësi për të dëshmuar problemet kombëtare dhe vendore të mjedisit, për të parë e për të menduar se si gjenden zgjidhjet dhe se si t'i trajtojmë këto sfida.

Të menduarit dhe të vepruarit e mençur na ndihmojnë që të prodhojmë e realizojmë ide se si mund të kontribuojmë për një mjedis më të mirë, pasi në këtë mënyrë marrim pjesë në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për të gjithë "për sot dhe e pakta për nesër", duke e garantuar edhe për brezat që vijnë.

Roli i OMShC është në rritje. Ato tashmë janë struktura të rëndësishme për të mundësuar pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes, duke siguruar që mendimet dhe pikëpamjet e tyre janë të nevojshe për t'u marrë në konsideratë.

Në vendin tonë, megjithë punë e bërë në kuadër të zbatimit të programit SENiOR-A (Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri), të financuar nga Qeveria Suedeze dhe asistencë të REC-Albania, ende ekziston një nevojë e madhe për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile në ngritjen e kapaciteteve, për të ndihmuar në vendosjen e bashkëpunimit me strukturat e AKZM dhe stafeve të rinjë të AdZM-ve sipas qarqeve.

Për ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për domosdoshmërinë e zbatimit të ligjit dhe të standarteve, gjithshtu, është i nevojshëm pjesëmarrja e komuniteteve dhe e OJF-ve në vendimmarrjet, forcimi dhe zbatimi konkret i veprimtarive gjithë përfshirëse vetëdijesuese, edukative dhe një komunikim transparent.

Shpesh ky rol është i penguar nga mungesa e kapaciteteve të duhura dhe aftësitë e komunikimit ndërmjet tyre. Njëherazi procesi është teje i rëndësishëm edhe për strukturat dhe stafet në ndërtim të bashkive, bazuar në ndarjen e re administrative të territorit të vendit.

Komunikimi me pjesëmarrjen e gjërë të publikut dhe të rrjetit të ruajtjes së natyrës, nëpërmjet zbatimit të praktikave më të mira për mbrojtjen e natyrës dhe përdorimin e integruar e të barazpeshuar të biodiversitetit, mbeten instrumente thelbësore për të rritur mbështetjen për

Adr.:Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania
Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org
INCA ALBANIA

këtë problem, për të kontribuar në menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore në Shqipëri.

Sigurimi i veprimeve që kontribuojnë në ruajtjen dhe konservimin e burimeve natyrore në Shqipëri, duke përforcuar kapacitetet dhe rolin e OJF-ve, është objektivi i përgjithshëm i projektit "Fuqizimi i OMShC-ve Shqiptare për promovimin e mbrojtjes së natyrës në Shqipëri", që po realizohet nga INCA.

Kësisoj, objektivat specifik të projektit konsistojnë:

- Për të rritur forcën, rolin dhe aftësitë e OMShC-ve në procesin e menaxhimit të zonës së mbrojtur si dhe zbatimin e ligjit, për të luftuar korrupsionin dhe për të zvogëluar ndikimin negativ në burimet natyrore.
- Për të inkurajuar bashkëpunimin operativ ndërmjet OMShC-ve dhe komunitetit, nxitjen dhe ndërtimin e partneritetit me të gjithë administratat kombëtare dhe lokale, duke ndërmarrë iniciativa dhe veprime të përbashkëta, që kanë për qëllim mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore në zonat e mbrojtura në 2 rajonet pilote të përzgjedhur (Gjirokastër dhe Kukës).
- Krijimin e një programi afatgjatë pune të bazuar në përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe të *acquis* të BE-së si dhe të iniciativave dobiprurëse në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Aktivitetet që parashikohen të realizohen do të jenë:

1. Takimet koordinuese dhe informuese për projektin.
2. Ngritja dhe funksionimi i një grupi aktiv të OMShC që kanë aktivitet ruajtjen e natyrës.
    - Identifikimi i OMShC aktive në rajonet pilot;
    - Krijimi i grupeve lokale të monitorimit për mbrojtjen e natyrës në rajonet pilote;
    - Krijimin e mekanizmave duke bërë të mundur vlerësimin dhe monitorimin e ZOO-s ekzistuese si dhe ruajtja e kafshëve të egra sipas standardeve.
3. Zhvillimi dhe zbatimi i programit të trajnimit për përforcimin e kapaciteteve të OMShC në analizimin e legjislacionit ekzistues për ruajtjen e natyrës si dhe për të monitoruar dhe raportuar zbatimin e tyre në praktikë.
    - Zhvillimi i udhëzimeve dhe materialeve të trajnimit.
    - Hartimin e një platforme hetimore që do të aplikohen në zonat e mbrojtura.
    - Kryerja e dy seminareve trajnuese (2 ditë) me OMShC në secilën prej zonave pilote. Hetimin vend për të kryer monitorimin në bazë të platformës hetimore përgatitur dhe paraqitur më parë.
4. Ngritja e vetëdijësimit publik në lidhje me situatën kritike për menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri.

Adr.:Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania
Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org
INCA ALBANIA

- Ndërmerrja e aktivitete promovuese në secilën rajonet pilote në kuadër të ditëve mjedisore, për Direktivën e BE-së "Natyra 2000", njohja me rezultatet kryesore të grumbulluara nga monitorimi dhe hetimi gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit. Reklama dhe spote audio do të transmetohet në televizionet lokale në vend, në gazetat lokale në lidhje me aktivitetet e projektit.

5. Hartimi i një dokumenti me analiza dhe rekomandime për mbrojtjen e natyrës për organet e qeverisjes kombëtare dhe lokale.

Nga zbatimi i aktiviteteve prarashikohen këto rezultate të pritshme:

1. Forcim të rolit të Rrjetit të OJF-të për aktivitetet mbikëqyrëse dhe të grumbullimit dhe analizimit të dhënave.
2. Rritja e kapaciteteve të OMShC dhe aktorëve lokalë, në lobim dhe teknikat e monitorimit për zbatimin e përafrimit të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e natyrës.
3. Kryerjen e një serie të veprimtarive mbikqyrëse për zbatimin aktual të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e natyrës.
4. Rritja e informimit të publikut mbi mangësitë dhe problemet me të cilat përballen në menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.
5. Mbështetja e përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mbushur boshllëqet në mes të legjislacionit kombëtar mjedisor dhe standardet e BE-së biodiversitetit.

Adr.:Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania
Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org
INCA ALBANIA